

<p style="text-align: center;">AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR</p> <p style="text-align: center;">“GreenPower Albania” SH.P.K</p> <p>Sot, më date 14.06.2021, bazuar në vullnetin e lirë dhe në përputhje me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe Ligjit 9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, personat e poshtëshënuar:</p> <p>1. Christian Karl Frenzel, i biri i Karl Frenzel lindur më datë 25.06.1961, në Bayreuth, Gjermani, mbajtës i pasaportës me Nr. CG05HPX5X, lëshuar nga STADT BAYREUTH</p> <p>Në cilësinë e përfaqësuesit të Këshillit të Administrimit të</p> <p style="text-align: center;">Shoqërisë gjermane “GreenPower Europe”AG</p> <p>Dhe në bazë të vendimit të Këshillit të Administrimit të “GreenPower Europe” AG, të datës 28.05.2021, vendosi të themelojë</p> <p style="text-align: center;">shoqërinë “GreenPower Albania” SH.P.K</p> <p>(që më poshtë do të referohet si “Shoqëria”) dhe të hartojë Statutin e shoqërisë.</p> <p>Shoqëria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë QKB sipas parashikimeve të Ligjit 9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.</p>	<p style="text-align: center;">GRÜNDUNGSAKT UND STATUTEN DER KOMMERZIELLEN GESELLSCHAFT MIT BESCHRÄNKTER HAFTUNG</p> <p style="text-align: center;">“GreenPower Albania” SH.P.K</p> <p>Heute, am 14.06.2021, aus freiem Willen und gemäß Gesetz Nr. 9901 vom 14.04.2008 "über Händler und Unternehmen", geändert und Gesetz Nr. 9723 vom 03.05.2007, "Über Geschäftsregistrierung", in der geltenden Fassung, die folgenden Personen:</p> <p>2. Christian Karl Frenzel, Sohn von Karl Frenzel, geboren am 25.06.1961 in Bayreuth, Deutschland, Inhaber eines PASSES mit Nr. CG05HPX5X, ausgestellt von der STADT BAYREUTH</p> <p>In der Eigenschaft als Mitglieder und Vertreter des Vorstandes</p> <p style="text-align: center;">der deutschen Gesellschaft “GreenPower Europe” AG</p> <p>und auf der Grundlage des Beschlusses des Vorstandes der GreenPower Europe AG vom 28.05.2021, wurde beschlossen,</p> <p style="text-align: center;">die Gesellschaft “GreenPower Albania” SH.P.K</p> <p>(nachstehend "Gesellschaft" genannt) zu gründen und das Gesellschaftsstatut auszuarbeiten.</p> <p>Die Gesellschaft erwirbt Rechtspersönlichkeit ab dem Tag der Eintragung in das Handelsregister bei der QKB gemäß den Bestimmungen des Gesetzes Nr. 9723 vom 03.05.2007 "Über die Registrierung von Unternehmen", geändert.</p>
<p style="text-align: center;"><u>Neni 1</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Objekti i veprimtarisë së shoqërisë</u></p> <p>Shoqëria ka si objekt kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një kompani me përgjegjësi të kufizuar mund të kryejë në përputhje me legjislacionin e Shqipërisë, brenda dhe</p>	<p style="text-align: center;"><u>Artikel 1</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Gegenstand der Tätigkeit des Unternehmens</u></p> <p>Der Zweck der Gesellschaft besteht darin, alle Tätigkeiten auszuführen, die eine Gesellschaft mit beschränkter Haftung gemäß den albanischen Rechtsvorschriften innerhalb und außerhalb des</p>

<p>jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përfshirë por pa u kufizuar në:</p> <p>Veprimtari kryesore e shoqërisë do të përqëndrohet në fushën e prodhimit, ruajtjes dhe shitjes së burimeve energjitike (si p.sh.: energjia elektrike, energjia e hidrogjenit etj) nëpërmjet sistemeve fotovoltaike, parqeve të erës, hidrocentraleve, si dhe impanteve të elektrolizës, të cilat ndërtohen dhe operohen nga shoqëria.</p>	<p>Hoheitsgebiets der Republik Albanien ausführen kann, einschließlich:</p> <p>Die Haupttätigkeit des Unternehmens wird sich uneingeschränkt im Bereich der Produktion, Speicherung und des Verkaufs von Energieressourcen (wie Elektrizität, Wasserstoff usw.) durch Photovoltaikanlagen, Windkraftanlagen, Wasserkraftwerke und Elektrolyseanlagen, die von der Gesellschaft gebaut und betrieben werden.</p>
<p style="text-align: center;"><u>Neni 2</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Emërtimi dhe Selia e Shoqërisë</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Emërtimi i shoqërisë është "GreenPower Albania", i ndjekur në mënyrë të pandashme nga shtojca "SH.P.K", që përfaqëson formën juridike të saj. 2. Selia e Shoqërisë në momentin e themelimit ndodhet në adresën: Rruga „Brigada VIII”, Pall. Lid, Kt. 2, Tiranë, Shqipëri. 3. Shoqëria mund të krijojë shoqëri bija, filiale, zyra përfaqësimi, degë dhe angjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit. 	<p style="text-align: center;"><u>Artikel 2</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Name und Firmensitz</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Der Name des Unternehmens lautet "GreenPower Albania", untrennbar mit dem Anhang "SHPK", der seine Rechtsform darstellt. 2. Der Sitz der Gesellschaft befindet sich zum Zeitpunkt der Gründung an der Adresse: Rruga „Brigada VIII”, Pall. Lid, Kt. 2, Tirane, Albanien 3. Die Gesellschaft kann in Albanien oder im Ausland Tochtergesellschaften, verbundene Unternehmen, Vertretungen, Zweigniederlassungen und Winkelstellen gründen.
<p style="text-align: center;"><u>Neni 3</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Regjimi juridik</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shoqëria është person juridik shqiptar, ka formën ligjore të një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, në përputhje me ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar. 2. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të këtij Statuti dhe legjislacionit shqiptar në fuqi. 	<p style="text-align: center;"><u>Artikel 3</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Gesetzliche Regelung</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Die Gesellschaft ist eine albanische juristische Person und hat die Rechtsform einer Gesellschaft mit beschränkter Haftung gemäß Gesetz Nr. 9901 vom 14.04.2008 "Über Händler und Unternehmensorganisationen", geändert. 2. Ihre Tätigkeit unterliegt den Bestimmungen dieser Satzung und den geltenden albanischen Rechtsvorschriften.
<p style="text-align: center;"><u>Neni 4</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Të drejtat e Shoqërisë dhe të Ortakëve</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje, të nënshkruajë kontrata në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. 2. Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale. 	<p style="text-align: center;"><u>Artikel 4</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Gesellschafts- und Gesellschafterrechte</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Das Unternehmen hat das Recht, Vereinbarungen zu treffen und Verträge im Gebiet der Republik Albanien und im Ausland zu unterzeichnen. 2. Die Gesellschaft hat das Recht, materiellen und intellektuellen Wohlstand zu schaffen.

<p>3. Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortak ose aksionar në shoqëri ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar.</p> <p>4. Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj të nënshkruar dhe me të mirat e pasurisë së saj. Ajo në asnjë rast nuk përgjigjet për detyrimet e ortakëve dhe as këta të fundit nuk mbajnë përgjegjësi personale për detyrimet që merr përsipër shoqëria.</p>	<p>3. Die Gesellschaft hat das Recht, als Partner oder Anteilseigner an verschiedenen Unternehmen oder Gesellschaften in Albanien oder im Ausland gemäß den albanischen Rechtsvorschriften teilzunehmen.</p> <p>4. Die Gesellschaft haftet gegenüber Dritten ausschließlich mit ihrem gezeichneten Kapital und ihrem Vermögen. Sie ist in keinem Fall für die Verpflichtungen der Gesellschafter verantwortlich, noch haften diese persönlich für die von der Gesellschaft übernommenen Verpflichtungen.</p>
<p style="text-align: center;"><u>Neni 5</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Kohëzgjatja</u></p> <p>Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një kohë të pa përcaktuar.</p>	<p style="text-align: center;"><u>Artikel 5</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Dauer</u></p> <p>Die Gesellschaft entwickelt ihre Tätigkeit für eine unbestimmte Zeit.</p>
<p style="text-align: center;"><u>Neni 6</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Kapitali i shoqërisë</u></p> <p>Kapitali i shoqërisë është i barabartë me 1.000.000 lekë. Kapitali i regjistruar është plotësisht i nënshkruar dhe i ndarë në 1 kuotë, të zotëruar nga ortaku i vetëm, përkatësisht si më poshtë :</p> <p>1. "GreenPower Europe" AG, zotëruese e një kuote me vlerë 1.000.000 lekë, me 100 % të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë.</p> <p>Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme ose të paluajtshme apo të drejta). Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.</p>	<p style="text-align: center;"><u>Artikel 6</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Das Kapital der Gesellschaft</u></p> <p>Das Kapital des Unternehmens beträgt 1.000.000 lekë. Das gezeichnete Kapital ist vollständig gezeichnet und geteilt in 1 Quote des alleinigen Gesellschafter unterteilt, wie folgt:</p> <p>1. "GreenPower Europe" AG, Inhaber einer Quote in der Wert von 1.000.000 lek, mit 100% des Grundkapitals der Gesellschaft.</p> <p>Der Beitrag des Gesellschafter kann in bar oder in Form von Sachwerten (bewegliches oder unbewegliches Eigentum oder Rechte) erfolgen. Die Gesellschaft haftet für die Verluste der Gesellschaft gegen Dritte bis zur Höhe des Stammkapitals der Gesellschaft</p>
<p style="text-align: center;"><u>Neni 7</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit</u></p> <p>Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet në çdo moment me vendim të asamblesë të përgjithshme të ortakëve, në përputhje me dispozitat e n.9901 ligjit 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Në çdo rast, kapitali i regjistruar nuk mund të</p>	<p style="text-align: center;"><u>Artikel 7</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Erweiterung und Kapitalherabsetzung</u></p> <p>Das Kapital der Gesellschaft kann jederzeit durch Beschluss der Gesellschafterversammlung in Übereinstimmung mit den Bestimmungen des Gesetzes Nr. 9901 vom 14.04.2008 "über Händler und Unternehmensorganisationen" erhöht oder</p>

<p>zvogëlohet nën kufirin minimal të parashikuar nga ligji.</p>	<p>verringert werden. In jedem Fall kann das Grundkapital nicht unter die gesetzlich vorgeschriebene Mindestgrenze gesenkt werden.</p>
<p style="text-align: center;"><u>Neni 8</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Drejtimi dhe Organet Kryesore</u></p> <p>Shoqëria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj. Emërtimi i Shoqërisë Tregtare, kapitali themeltar, duhet të jenë të përmendura në të gjitha aktet dhe dokumentet që nxjerr kjo shoqëri dhe që ju drejtohen të tretëve.</p> <p>Organet kryesore të Shoqërisë janë: - Asambleja e Ortakëve; - Administratori;</p>	<p style="text-align: center;"><u>Artikel 8</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Führung und Hauptorgane</u></p> <p>Das Unternehmen erhält ab dem Zeitpunkt der Registrierung Rechtspersönlichkeit. Der Name der Gesellschaft und das Stammkapital, sollte in allen von dieser Gesellschaft herausgegebenen Akten und Dokumenten genannt werden und an Dritte gerichtet sein.</p> <p>Die Hauptorgane der Gesellschaft sind: - die Versammlung der Gesellschafter; - Geschäftsführer;</p>
<p style="text-align: center;"><u>Neni 9</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Asambleja e Ortakëve të shoqërisë</u></p> <p>Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë dhe vendimet e saj janë të detyrueshme. Të drejtën e thirrjes së Asamblesë e kanë Administratori, ose ortakët të cilët zotërojnë të paktën 5 % e kapitalit themeltar të shoqërisë. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve bëhet me letër rekomande të paktën 7 ditë përpara datës së mbledhjes, duke parashtruar rendin e ditës dhe dokumentacionin që do të shqyrtohet.</p> <p>Mbledhja e Asamblesë thirret detyrimisht një herë në vit dhe jo më vonë se fundi i 6-mujorit të parë.</p>	<p style="text-align: center;"><u>Artikel 9</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Die Versammlung der Gesellschafter</u></p> <p>Die Versammlung der Gesellschafter ist das höchste Entscheidungsorgan der Gesellschaft und ihre Entscheidungen sind verbindlich. Das Recht der Versammlung auf Abruf ist der oder die Gesellschafter, die mindestens 5% des Stammkapitals der Gesellschaft besitzen. Die Einberufung der Versammlung der Gesellschafterversammlung muss mindestens sieben Tage vor dem Sitzungstag per Einschreiben unter Angabe der Tagesordnung und der zu prüfenden Unterlagen erfolgen.</p> <p>Die Versammlung der Gesellschafter ist obligatorisch einmal im Jahr und spätestens am Ende der ersten sechs Monate.</p>
<p style="text-align: center;"><u>Neni 10</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Të drejtat dhe detyrimet e Asamblejsë së Përgjithshme</u></p> <p>Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë; b) ndryshimet e statutit; c) emërimin e shkarkimin e administratorëve; d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; 	<p style="text-align: center;"><u>Artikel 10</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Rechte und Pflichten der Generalversammlung</u></p> <p>Die Generalversammlung ist für Entscheidungen in Bezug auf das Unternehmen in folgenden Angelegenheiten verantwortlich:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Festlegung der Handelsrichtlinien des Unternehmens; b) Satzungsänderungen; c) Ernennung und Entlassung von Administratoren;

<p>e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;</p> <p>f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;</p> <p>g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;</p> <p>h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;</p> <p>i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;</p> <p>j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;</p> <p>k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;</p> <p>l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;</p> <p>m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji.</p>	<p>d) die Ernennung und Abberufung von zugelassenen Liquidatoren und Buchhaltungsexperten;</p> <p>e) Festlegung der Vergütung für die in den Buchstaben "c" und "d" genannten Personen;</p> <p>f) Überwachung der Umsetzung der Handelspolitik durch die Geschäftsführer, einschließlich der Erstellung von Jahresabschlüssen und Fortschrittsberichten der Tätigkeit;</p> <p>g) die Genehmigung des Jahresabschlusses und der Fortschrittsberichte der Tätigkeit;</p> <p>h) Kapital erhöhen und reduzieren;</p> <p>i) Aufteilung der Quoten und deren Auflösung;</p> <p>j) Vertretung der Gesellschaft vor Gerichten und anderen Verfahren gegen die Verwalter;</p> <p>k) Umstrukturierung und Liquidierung der Gesellschaft;</p> <p>l) Annahme von Verfahrensregeln für Versammlungssitzungen;</p> <p>m) andere gesetzlich vorgesehene Fragen.</p>
<p style="text-align: center;"><u>Neni 11</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Administrimi</u></p> <p>Administrator i shoqërisë emërohet në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar, me të drejtë ripërtëritje. Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë. Administrator i parë i shoqërisë është Z. Fabian Hellbach, lindur më 16 gusht 1997, në Bayreuth dhe banues në 95447 Bayreuth, Ginsterweg 4, identifikuar nëpërmjet dokumentit të identifikimit Pasaportë me Nr. CG055H0PN7.</p>	<p style="text-align: center;"><u>Artikel 11</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Verwaltung</u></p> <p>Der Geschäftsführer des Unternehmens wird für eine Amtszeit von fünf Jahren ernannt. Der Geschäftsführer wird durch Beschluss der Vereinigung der Gesellschafter der Gesellschaft ernannt und entlassen. Der erste Geschäftsführer des Unternehmens ist Herr Fabian Hellbach, geboren am 16.08.1997 mit Paß-Nummer CG055H0PN7.</p>
<p style="text-align: center;"><u>Neni 12</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Kompetencat</u></p> <p>Administratori ka të drejtë të:</p> <p>a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;</p> <p>b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;</p> <p>c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;</p> <p>ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së</p>	<p style="text-align: center;"><u>Artikel 12</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Befugnisse</u></p> <p>Der Geschäftsführer hat das Recht:</p> <p>a) alle Handlungen der Verwaltung der Geschäftstätigkeit des Unternehmens durchführen, indem sie die von der Generalversammlung festgelegten Handelsrichtlinien anwenden;</p> <p>b) Vertretung der Geschäftsorganisation;</p> <p>c) sorgt für die korrekte und regelmäßige Aufbewahrung der Dokumente und Bücher des Unternehmens;</p> <p>d) Der Geschäftsführer hat das Recht, alle gewöhnlichen und außerordentlichen Verwaltungshandlungen durchzuführen.</p>

<p>përgjithshme për miratim;</p> <p>d) Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.</p> <p>e) Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.</p> <p>Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.</p>	<p>e) Der Geschäftsführer vertritt die Gesellschaft vor allen natürlichen und juristischen Personen, öffentlichen und/oder privaten, inländischen oder ausländischen und staatlichen Behörden, einschließlich Justizbehörden aller Grade. Der Geschäftsführer hat alle Befugnisse, in Beziehungen mit Dritten für die Gesellschaft zu handeln, unter allen Umständen mit Ausnahme der Befugnisse, die das Gesetz den Gesellschafter der Gesellschaft ausdrücklich gewährt.</p> <p>Der Geschäftsführer bindet die Gesellschaft in Beziehungen mit Dritten durch Handlungen ein, die mit ihrem Ziel vereinbar sind.</p>
<p style="text-align: center;"><u>Neni 13</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Viti Financiar</u></p> <p>Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.</p>	<p style="text-align: center;"><u>Artikel 13</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Geschäftsjahr</u></p> <p>Das Geschäftsjahr der Gesellschaft beginnt am 1. Januar und endet am 31. Dezember.</p>
<p style="text-align: center;"><u>Neni 14</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Dividenti</u></p> <p>Shoqëria vendos nese të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme paguhen ose jo ndaj ortakut.</p>	<p style="text-align: center;"><u>Artikel 14</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Dividende</u></p> <p>Die Gesellschaft entscheidet, ob nach der Trennung der oben genannten gesetzlichen Mittel das verbleibende Nettoeinkommen (Dividende) an den Gesellschafter ausbezahlt wird oder nicht.</p>
<p style="text-align: center;"><u>Neni 15</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Shpërndarja ose likuidimi i shoqërisë</u></p> <p>Shpërndarja ose likuidimi i shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :</p> <p>a) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;</p> <p>b) me hapjen e procedurave të falimentimit;</p> <p>c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit";</p> <p>ç) me vendim të gjykatës;</p> <p>Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme merr vendim</p>	<p style="text-align: center;"><u>Artikel 15</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Verteilung oder Liquidierung der Gesellschaft</u></p> <p>Die Verteilung oder Liquidierung des Gesellschaft kann jederzeit erfolgen:</p> <p>a) durch Beschluss der Gesellschafterversammlung;</p> <p>b) Eröffnung eines Insolvenzverfahrens;</p> <p>c) wenn die Gesellschaft seit zwei Jahren keine gewerbliche Tätigkeit ausübt und die Aussetzung der Tätigkeit nicht gemäß Artikel 43 Nummer 3 des Gesetzes Nr. 9723 vom 3.5.2007 "Über die Gewerbeanmeldung" gemeldet wurde;</p> <p>d) durch gerichtliche Entscheidung;</p>

<p>me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtësën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".</p> <p>Prishja e shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.</p> <p>Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.</p> <p>Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.</p>	<p>In diesem Fall trifft der Versammlung der Gesellschafter eine schriftliche Entscheidung, die die Liquidation der Gesellschaft vorsieht, indem er einen oder mehrere Liquidatoren bestellt und in jedem von ihm ausgestellten Dokument den Namen des Liquidators und den zusätzlichen Namen "Gesellschaft in Liquidation" aufführt.</p> <p>Die Schliessung des Unternehmens hat die Eröffnung von Liquidationsverfahren im Solvenzzustand zur Folge, außer in den Fällen, in denen ein Insolvenzverfahren eingeleitet wurde.</p> <p>Die Liquidation wird von Liquidatoren durchgeführt, die von der Gesellschafterversammlung bestellt werden.</p> <p>Wenn die Gesellschafterversammlung nicht innerhalb von 30 Tagen nach der Schliessung über die Bestellung der Liquidatoren entscheidet, kann sich jede interessierte Person an das Gericht wenden, um einen Liquidator zu bestellen.</p>
<p style="text-align: center;"><u><i>Neni 16</i></u></p> <p style="text-align: center;"><u><i>Likuiduesi</i></u></p> <p>Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.</p> <p>Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.</p> <p>Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.</p> <p>Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së Asamblesë së Ortakëve dhe administratorit.</p>	<p style="text-align: center;"><u><i>Artikel 16</i></u></p> <p style="text-align: center;"><u><i>Der Liquidator</i></u></p> <p>Der Liquidator übernimmt die Rechte und Pflichten von Geschäftsführern ab dem Zeitpunkt seiner Bestellung.</p> <p>Wenn die Gesellschaft mehr als einen Insolvenzverwalter bestellt, üben die Insolvenzverwalter die Rechte und Pflichten aus diesem Gesetz gemeinsam aus, sofern die Ernennung nicht dazu führt, dass sie getrennt voneinander handeln. Insolvenzverwalter können einen von ihnen ermächtigen, Maßnahmen einer bestimmten Kategorie durchzuführen.</p> <p>Die Begrenzungen der Ansprüche der Liquidatoren richten sich nach den gesetzlichen Bestimmungen gegen Dritte.</p> <p>Der Liquidator unterliegt der Aufsicht der Gesellschafterversammlung und des Geschäftsführers.</p>
<p style="text-align: center;"><u><i>Neni 17</i></u></p> <p style="text-align: center;"><u><i>Përfundimi i likuidimit</i></u></p> <p>Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e</p>	<p style="text-align: center;"><u><i>Artikel 17</i></u></p> <p style="text-align: center;"><u><i>Abschluss der Liquidation</i></u></p> <p>Nach der Veräußerung der verbleibenden Vermögenswerte benachrichtigt der Liquidator das National Business Center für den Abschluss der</p>

<p>shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.</p>	<p>Liquidation und verlangt die Abmeldung der Gesellschaft gemäß Abschnitt V des Gesetzes Nr. 9723 vom 3.5.2007 "zur Eintragung von Unternehmen" in der jeweils gültigen Fassung.</p>
<p style="text-align: center;"><u><i>Neni 18</i></u></p> <p style="text-align: center;"><u><i>Ndarja</i></u></p> <p>Shoqëria mund të ndahet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, duke transferuar të gjitha aktivitetet e pasivitetet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008.</p>	<p style="text-align: center;"><u><i>Artikel 18</i></u></p> <p style="text-align: center;"><u><i>Gemeinsame Nutzung</i></u></p> <p>Die Gesellschaft kann durch einen Beschluss der Gesellschafterversammlung geteilt werden, indem alle ihre Vermögenswerte und Verbindlichkeiten auf zwei oder mehr bestehende oder neu gegründete Unternehmen übertragen werden. Die geteilte Gesellschaft gilt als gebrochen. Die Bestimmungen der Artikel 216 bis 225 des Gesetzes 9901 vom 14.04.2008 gelten jeweils für die Spaltung der Gesellschaft.</p>
<p style="text-align: center;"><u><i>Neni 19</i></u></p> <p style="text-align: center;"><u><i>Shndërrimi</i></u></p> <p>Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.</p>	<p style="text-align: center;"><u><i>Artikel 19</i></u></p> <p style="text-align: center;"><u><i>Transformation</i></u></p> <p>Die Gesellschaft kann ihre Rechtsform ändern, indem sie sie in eine Aktiengesellschaft umwandelt. Die Konversion hat keine Auswirkungen auf die Rechte und Pflichten, die die Gesellschaft an Dritte übernommen hat.</p>
<p style="text-align: center;"><u><i>Neni 20</i></u></p> <p style="text-align: center;"><u><i>Baza Ligjore</i></u></p> <p>Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.</p>	<p style="text-align: center;"><u><i>Artikel 20</i></u></p> <p style="text-align: center;"><u><i>Rechtliche Grundlage</i></u></p> <p>Die Gesellschaft führt ihre Tätigkeit in voller Übereinstimmung mit dieser Satzung und den albanischen Rechtsvorschriften durch. Wie in dieser Satzung vorgesehen, gelten die Bestimmungen des Gesetzes "Über Händler und Gesellschaften", des Zivilgesetzbuches und anderer spezifischer Gesetze in der Republik Albanien.</p>
<p style="text-align: center;"><u><i>Neni 21</i></u></p> <p style="text-align: center;"><u><i>Mosmarrëveshjet</i></u></p> <p>Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me</p>	<p style="text-align: center;"><u><i>Artikel 21</i></u></p> <p style="text-align: center;"><u><i>Streitigkeiten</i></u></p>

<p>zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.</p>	<p>Anwendung oder Auslegung dieser Satzung auftreten können, sowie bei Streitigkeiten, die zwischen der Gesellschaft und Dritten auftreten können, ist das albanische Gericht zuständig.</p>
<p style="text-align: center;"><u>Neni 22</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Dispozita perfundimtare</u></p> <p>Ky Akt dhe Statut u redaktua në 4 ekzemplare me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet me vullnetin e tij të lirë nga ortaket themelues.</p>	<p style="text-align: center;"><u>Artikel 22</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Schlussbestimmung</u></p> <p>Dieses Gesetz und die Satzung wurden in vier Exemplaren desselben rechtlichen Wertes in albanischer und deutscher Sprache bearbeitet und von den Gründungspartnern mit freiem Willen unterzeichnet.</p>
<p style="text-align: center;">ORTAKU</p> <p style="text-align: center;">“GreenPower Europe” AG</p> <p style="text-align: center;">përfaqësuar nga anëtari i Këshillit të Administrimit</p> <p style="text-align: center;">Z. Christian Karl Frenzel</p>  <p style="text-align: center;">(Nenshkrimi)</p>	<p style="text-align: center;">GESELLSCHAFTER</p> <p style="text-align: center;">“GreenPower Europe” AG</p> <p style="text-align: center;">vertreten durch den Vorstand</p> <p style="text-align: center;">Herr Christian Karl Frenzel</p>  <p style="text-align: center;">(Unterschrift)</p>

